



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Indeksi i Çmimeve të Importit

TM1 2024

ASK ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) në qershor 2009. Çmimet e importit filluan të mbliidhen në fillim të 2006. Çmimet mbliidhen në bazë tremujore dhe mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave për periudhën tremujori i parë 2006 – tremujori i parë 2024.

Publikimi përmban tabelën e Indeksit të Çmimeve të Importit në Kosovë në bazë tremujore, TM1 2015 –TM1 2024, mesatarja vjetore për 2015 - 2023 (2010 = 100) me ndryshime tremujore dhe vjetore në përqindje, me prezantim grafikësh, tabela për pesha, indeksin tremujor për TM1 2024, ndryshimet tremujore (TM4 2023 –TM1 2024) dhe ndryshimet vjetore (TM1 2023 –TM1 2024) për sektorët sipas Sistemit të Harmonizuar.

IÇIMP është përgatitur në përputhje me standardet dhe metodologjitë evropiane dhe në bashkëpunim me ekspertët nga Statistika e Suedisë dhe Agjencioni Suedez i Zhvillimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA). IÇIMP është në zhvillim e sipër dhe në të ardhmen do të shtohen më shumë vrojtime të çmimeve.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën e ueb infoask@rks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha – Drejtor i Departamentit

Arlinda Mataj – U.d.Shefe divizioni

Elvira Tahiri – Zyrtare e statistikave të çmimeve të importit

Maj, 2024

U.d i Kryeshefit Ekzekutiv i ASK,
Avni Kastrati

Simbolet dhe Shkurtesat

IÇIMP	Indeksi i Çmimeve të Importit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
OBD	Organizata Botrore e Doganave
TM1	Tremujori i parë
TM2	Tremujori i dytë
TM3	Tremujori i tretë
TM4	Tremujori i katërt
:	Shifra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
W	Ponderët statistikor (pesha specifike)
∅	Mesatare

Përmbajtja

	Faqe
Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) për tremujorin e parë 2024.....	4
Tab. 1:Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2015–TM1 2024 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje	5
Fig. 1:Zhvillimi i IÇIMP, TM1 2015 – TM1 2024 (2010=100)	6
Tab. 2:Peshat, numrat e Indeksi, ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje sipas sektorëve të Sistemit të Harmonizuar	7
Metodologjia	8.9

Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) për tremujorin e parë 2024

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë pati ngritje për 2.5 % në TM1 2024 krahasuar me TM4 2023. Krahasuar me TM1 2023 çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 2.4 %.

Tremujori i katërt 2023 – Tremujori i parë 2024 2.5%

Çmimet e importit në Kosovë patën një ngritje në një mesatare prej 2.5 % në TM1 2024 krahasuar me TM4 2023. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin lëkura dhe artikujt e saj (14.5%), vajrat ushqyese (10.1%), te instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinal, muzikorë dhe mekanizmat e orës (7.9%), produktet bimore (6.1%), produktet minerale (5.4%), shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (5.1%), mjetet e transportit (3.3%), artikujt e ndryshëm të prodhuar (3.0%), pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (2.3%), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (1.9%), produktet e industrive kimike (1.6%), tekstili dhe artikujt e tekstilit (1.2 %), letrat dhe artikujt e saj (1.1%), artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani (0.3%), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (0.3%), artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (0.3%), dhe këpucët (0.2%).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve, druri dhe artikujt e tij (-0.3%).

Tremujori i parë 2023 - Tremujori i parë 2024 2.4 %

Çmimet e Importit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 2.4 % në mes TM1 2024 dhe TM1 2023.


Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (14.0 %), tekstili dhe artikujt e tekstilit (11.2%), produktet bimore (10.4 %), mjetet e transportit (9.6%), lëkura dhe artikujt e saj (7.3%), artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani (6.1%), këpucët (4.8%), artikujt e ndryshëm të prodhuar (2.5%), letrat dhe artikujt e saj (1.4%), shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (1.3%), pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (1.2%), dhe produktet e industrive kimike (1.2%).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit te vajrat ushqyese (-6.4%), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-3.4%), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-3.2%), druri dhe artikujt e tij (-2.3%), produktet minerale (-1.5%), dhe artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (-1.4%).

Tab. 1:Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2015–TM1 2024 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje

Viti	Tremujori	Indeksi (2010 = 100)	Ndryshimi tremujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
2015	TM 1	113.8	-0.5	-1.4
	TM 2	114.1	0.3	-0.2
	TM 3	113.9	-0.2	-0.8
	TM 4	111.8	-1.8	-2.3
	Mesatarja vjetore 2015	113.4	:	-1.2
2016	TM 1	108.8	-2.6	-4.4
	TM 2	109.6	0.7	-3.9
	TM 3	110.7	1.0	-2.8
	TM 4	113.2	2.2	1.3
	Mesatarja vjetore 2016	110.6	:	-2.5
2017	TM 1	114.4	1.1	5.2
	TM 2	114.3	-0.1	4.3
	TM 3	115.3	0.9	4.2
	TM 4	116.0	0.6	2.5
	Mesatarja vjetore 2017	115.0	:	4.0
2018	TM 1	116.0	0.0	1.4
	TM 2	117.0	0.9	2.4
	TM 3	117.9	0.8	2.3
	TM 4	120.5	2.1	3.8
	Mesatarja vjetore 2018	117.8	:	2.5
2019	TM 1	120.0	-0.4	3.5
	TM 2	121.6	1.3	3.9
	TM 3	120.5	-0.9	2.1
	TM 4	120.0	-0.3	-0.3
	Mesatarja vjetore 2019	120.5	:	2.3
2020	TM 1	119.3	-0.6	-0.6
	TM 2	117.3	-1.6	-3.5
	TM 3	117.7	0.3	-2.3
	TM 4	118.4	0.5	-1.4
	Mesatarja vjetore 2020	118.2	:	-1.9
2021	TM 1	122.3	3.3	2.5
	TM 2	126.4	3.4	7.7
	TM 3	135.0	6.8	14.7
	TM 4	141.6	4.9	19.6
	Mesatarja vjetore 2021	131.3	:	11.1
2022	TM 1	149.0	5.2	21.8
	TM 2	155.9	4.6	23.3
	TM 3	158.6	1.7	17.5
	TM 4	160.1	1.0	13.0
	Mesatarja vjetore 2022	155.9	:	18.7
2023	TM 1	161.9	1.1	8.6
	TM2	162.5	0.4	4.2
	TM3	163.4	0.6	3.0
	TM 4	161.8	-1.0	1.0
	Mesatarja vjetore 2023	162.4	:	4.2
2024	TM1	166.0	2.5	2.4

Fig. 1: Zhvillimi i IÇIMP, TM1 2015 – TM1 2024 (2010=100)



Tab. 2: Peshat, numrat e Indeksi, ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje sipas sektorëve të Sistemit të Harmonizuar

Kodi	Grupi	Pesha	TM1- 2024 2010 =100	TM1 - 2024 TM4-2023	TM1 - 2024 TM1 - 2023
01-21	IÇIMP - Gjithsej	1000	166.0	2.5	2.4
01	Shtazët e gjalla; produktet e shtazëve	38	184.0	5.1	1.3
02	Produktet bimore	50	369.6	6.1	10.4
03	Vajrat ushqyese	10	219.2	10.1	-6.4
04	Artikuj ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani	131	137.0	0.3	6.1
05	Produktet minerale	147	232.3	5.4	-1.5
06	Produktet e industrive kimike	80	128.1	1.6	1.2
07	Plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre	64	156.5	1.9	-3.2
08	Lëkura dhe artikujt e saj	2	118.3	14.5	7.3
09	Druri dhe artikujt e tij	26	181.2	-0.3	-2.3
10	Letrat dhe artikujt e saj	16	134.6	1.1	1.4
11	Tekstili dhe artikujt e tekstit	44	101.6	1.2	11.2
12	Këpucët	12	155.3	0.2	4.8
13	Artikujt e gurit, të llaçit, produktet e keramikës dhe te qelqit	34	194.0	0.3	-1.4
14	Margaritarët, gurët e çmuar, metalet, etj.	:	:	:	:
15	Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	100	168.4	0.3	-3.4
16	Paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike	118	123.5	2.3	1.2
17	Mjetet e transportit	88	152.0	3.3	9.6
18	Instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës	10	127.3	7.9	14.0
19	Armët dhe municioni	:	:	:	:
20	Artikujt e ndryshëm të prodhuar	28	132.5	3.0	2.5
21	Veprat e artit	:	:	:	:

Shpjegime metodologjike

Çmimet grumbullohen në bazë tremujore në 7 qendra regjionale të Kosovës: Gjakovë, Gjilan Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj të cilat mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave.

Duke filluar nga tremujori i parë 2006, çmimet u grumbulluan në bazë tremujore për rreth 180 artikujt nga shtatëdhjetë kompani. Gjatë 2006 shumë vlerësime të reja të çmimeve u shtuan dhe për periudhën 2007-2008 numri i çmimeve të grumbulluara ishte rreth 250. Nga 2009 numri i çmimeve të grumbulluara ishte rreth 300, kurse nga viti 2015 numri i çmimeve është mbi 500 artikuj, ndërsa nga 2018 numri i çmimeve të grumbulluara është rreth 600.

Rezultatet janë prezentuar sipas Sistemit të Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganeve (OBD).

Të dhënat e çmimeve janë grumbulluar për një mostër të transaksioneve tipike lidhur me mallrat e importuara në Kosovë

Mostrimi dhe kalkulimi i peshave

Mostra është projektuar nga të dhënat e tregëtisë së jashtme. Këto të dhëna janë përdorur gjithashtu edhe për kalkulimin e peshave specifike. Peshat janë bazuar në informatën nga të dhënat tregëtare V-1 (viti paraparak) dhe janë freskuar në bazë vjetore. Me anë të freskimit të peshave për çdo vit, shporta e IÇIM-së do të reflektojë ndryshimet në mostrat e tregëtisë. IÇIM-ja do të ndikohet nga të dyja ndryshimet e çmimeve dhe nga ndryshimet e strukture së importit

Variablët statistikor

Variabli kryesor është çmimi; ai mund të raportohet në çdo njësi monetare. Çmimet e raportuara në njësi të huaja monetare konvertohen në EURO. Njësia monetare e faturës dhe raportimit janë, prandaj si variabël plotësues. Kur çmimet raportohen në njësi të huaja monetare, atëherë përdoren tarifrat e këmbimit të mesatarës tremujore të Bankës Qendrore Suedeze për konvertimin e tyre në EURO.

Formulat e indeksit

Indeksi i çmimeve të importit mund të përshkruhet si një indeks i llojit zinxhiror të Laspeyres-it me lidhje vjetore. Indeksi i Laspeyres-it definohet si në vijim.

$$I^t = \frac{\sum_{i=1}^n P_i^t Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} = \sum_{i=1}^n \frac{P_i^0 Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} \times \frac{P_i^t}{P_i^0}$$

Ku P^0 dhe P^t janë çmimet për njësi në periodën bazë (0) dhe perioda e krahasimit (t), përkatësisht, dhe Q^0 është sasia e periodës bazë. Mbledhja bëhet nëpërmes produkteve n. Në elementin qendror të mësipërm, indeksi shprehet me shkallën mes vlerës së mbledhur të shumave të periodës bazë në periodën e krahasimit dhe në nivelin e çmimit të periodës bazë, përkatësisht. Indeksi gjithashtu mund të shprehet, si në elementin final, si një mesatare e përafërt e çmimit të mallërave të peshuar me vlerat e periodës.

Çmimet e indeksit kalkuloohen me një tremujor aktual në vit si periudhë e krahasimit dhe me tremujorin e katërt në vitin **y-1** si period e references së çmimit. Perioda e peshimit është viti **y-1**. Në këtë mënyrë lidhja definohet si:

$$I_{y-1,q}^{y,q} = \sum_{s=1}^k \frac{V_s}{\sum_{s=1}^k V_s} \times \frac{P_s^{y,q}}{P_s^{y-1,q}}$$

Ku pasha e vlerës V_s është vlera e transakcioneve në vit e që përfaqësohen me specifikacionin **s**. Mbledhja bëhet nëpërmes specifikacioneve **k**.

Kalkulimi i indeksit zinxhiror të IÇIMP

Numri i indeksit zinxhiror kalkulohet për tremujorët dhe tregon nivelin e veçantë të çmimit të tremujorit krahasuar me nivelin e çmimit mesatar në 2010 (2010=100).

$$I_{2010}^{y,q} = \frac{100}{\frac{1}{4} \sum_{q=1}^4 I_{2009,q}^{2010,q}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,q}^{Y,q} \times I_{y-1,q}^{y,q}$$

Kalkulimi i ndryshimeve

Ndryshimi tremujor kalkulohet si:

$$\left[\left(\frac{IMPI_0^{y,q}}{IMPI_0^{y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshim i përqindjes tremujore}$$

$IMPI_0^{y,q}$ = Indeksi i çmimeve të importit për tremujorin aktual q

$IMPI_0^{y,q-1}$ = Indeksi i çmimeve të importit për tremujorin e mëparshëm q-1

Ndryshimi vjetor kalkulohet si:

$$\left[\left(\frac{IMPI_{2010}^{y,q}}{IMPI_{2010}^{y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshim i përqindjes vjetore}$$

$IMPI_{2010}^{y,q}$ = Indeksi zinxhiror i çmimeve të importit për tremujorin aktual q

$IMPI_{2010}^{y-1,q}$ = Indeksi zinxhiror i çmimeve të importit për vitin dhe për tremujorin paraprak q

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.